



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjiçanit 01. nr. 016-126211 dt. 06.11.2014, me ndryshimet dhe plotësimet në Statut 01. nr. 016-28448 të datës 22.03.2018, dhe në zbatim të nenit 8 të Rregullores (MF) nr.04/2017, mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, të dt.13.06.2017, Kryetari i Komunës së Gjiçanit merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e komisionit vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve lidhur me Thirrjen Publike për mbështetje financiare të projekteve të OJQ-ve në DSHMS

1. Me këtë vendim, emërohet komisioni vlerësues për shqyrtimin e aplikacioneve lidhur me Thirrjen Publike për mbështetje financiare, publike të projekteve të OJQ-ve në DSHMS.
2. Komisioni vlerësues përbëhet nga 5 anëtarë:
 - 2.1. Salihe Aliu - DSHMS
 - 2.2. Filloreta Idrizi -DBF
 - 2.3. Nëntor Shaqiri-ZK
 - 2.4. Shkelzen Balaj-ekspert i jashtëm –OJQ
 - 2.5. Afërdita Kqiku-eksperte e jashtme
 - 2.6. Merushe Ajeti Haziri-anëtare rezervë në rast konflikti të interesit
3. Mandati i komisionit do të jetë një vjeçar.
4. Anëtarët në cilësinë e ekspertit të jashtëm, janë emëruar sipas Thirrjes Publike.
5. Detyrat e komisionit do të jenë sipas rregullores së punës që parashihet me Rregulloren (MF) nr.04/2017, mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, datë 13.06.2017.
6. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Gjiçanit.
7. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të tij.

Me këtë vendim njoftohen:

- Anëtarët e komisionit
- DSHMS dhe
- Arkivi

Kryetari i Komunës
Alban Hyseni